



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 556 Akti

Nr. 629 Vendimi

Tiranë, më 3.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Roland Ilia</b>	Relator
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 2.3.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Besnik Cengu**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisioner Roland Ilia, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Besnik Cengu, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Besnik Cengu u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në qershor të vitit 2020 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, nga i cili rezultoi se do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioner Rolanda Ilia.
3. Me vendimin nr. 1, datë 19.6.2020, kryesuese e trupit gjykues u zgjodh komisionerja Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mungesën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit Besnik Cengu ka filluar në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.
5. Subjekti i rivlerësimit Besnik Cengu, me kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2022, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ka kërkuar miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes, duke shpjeguar edhe arsyet e tij.
6. Në vijim, Komisioni administroi shkresën<sup>1</sup> e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me anë të së cilës përcillej vendimi “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror Besnik Cengu”.
7. Komisioni vëren se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 164, pika 8, nenin 166, pika 2, nenin 189, germa “a” dhe nenin 190, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 27, pikat 1, 1/2 dhe 3, nenin 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, vendosi të deklarojë miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit Besnik Cengu në datën 14.2.2023. Për këtë vendim, krahas Komisionit, është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit Besnik Cengu.
8. Komisioni, me anë të *email*-it datë 8.2.2023, në lidhje me dorëheqjen e dhënë, i kërkoi subjektit të konfirmonte këtë fakt konfirmimi, vullnet të cilin mund ta paraqiste në dy mënyra: (i) në seancë dëgjimore, si një e drejtë e dhënë, sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit

<sup>1</sup>Nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2023, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2023.

nr. 84/2014; (ii) me anë të postës elektronike, në adresën e *email*-it që komunikon për efekt të procesit të rivlerësimit, nëse nuk dëshiron të paraqitet në seancë dëgjimore dhe të konfirmojë më vullnetin e tij të lirë dhe të pavesuar në lidhje me dorëheqjen e dhënë pranë KLP-së.

**9.** Me *email*-in e datës 10.2.2023, subjekti Besnik Cengu ktheu përgjigje se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën dëgjimore dhe nuk do të ushtrojë ankim ndaj vendimit të KLP-së për ndërprerjen e statusit të magjistratit. Por më vonë, me *email*-in e datës 15.2.2023, subjekti Besnik Cengu u shpreh se *bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kërkoi të njoftohej për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore, duke iu njoftuar data e seancës, ora dhe salla ku do të zhvillohej seanca dëgjimore.*

**10.** Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2023, i kërkoi Gjykatës Administrative të Apelit nëse subjekti Besnik Cengu kishte ushtuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të KLP-së. Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2023, ka kthyer përgjigje, duke informuar se z. Besnik Cengu deri në këtë datë nuk ka paraqitur ndonjë kërkesëpadi.

**11.** Komisioni, në datën 28.2.2023, vendosi thirrjen e subjektit Besnik Cengu për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore të datës 2.3.2023. Për këtë, subjekti është njoftuar me *email*-in e datës 28.2.2023.

**12.** Komisioni konstaton se deri në këtë fazë duket se është shprehur vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi z. Besnik Cengu duket se ka paraqitur dorëheqjen para Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit. Subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi, i cili duket se ka marrë formë të prerë. Në këtë drejtim rezulton se Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në lidhje me praktikën e gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në faza të ndryshme të tij, po kështu edhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

**13.** Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare<sup>2</sup>.

- Në germën "a", pika 1 e nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

- Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

---

<sup>2</sup>Referohuni vendimit nr. 1/2018 (JR), datë 11.6.2018, paragrafëve 96 dhe 97 të tij, të Kolegjit.

*“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.*

*2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.*

- Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

*“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

*2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

- Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

*“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.*

*2. Pas dhënies së dorëheqjes subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1 e ligjit ‘Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit’”.*

**14.** Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

*“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.*

**15.** Në këto kushte, referuar fakteve të evidentuara më lart, Komisioni konstaton se deri në këtë fazë duket se ka rrethana që procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Besnik Cengu, prokuror, duhet të ndërpritet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

16. Për sa më sipër, me *email*-in e datës 28.2.2023, subjektit iu dërgua një rezultat mbi këtë proces dhe iu kërkuan shpjegime<sup>3</sup> lidhur me konstatimet paraprake të Komisionit, përshkruar më sipër në pikën 15.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit<sup>4</sup> në lidhje me kërkimin e Komisionit**

17. Subjekti në parashtrimet e tij ka deklaruar se si subjekt rivlerësimi, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar të gjitha procedurat ligjore të rivlerësimit, duke dërguar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të ligjit, si dhe ka bashkëpunuar në mënyrë korrekte me Komisionin. Ai ka qartësuar se në datën 12.12.2022 i është drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke i paraqitur kërkesën “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit”, bazuar në nenin 27, pikat 1, 1/2 dhe 64, pika 1, germa “c” e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, bazuar në nenin 27, pikat 1, 1/2 dhe 3, nenin 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2022, të paraqitur prej tij, me propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, ka vendosur: “1. *Miratimin e pensionit të parakohshëm për z. Besnik Cengu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.* 2. *Mbarimin e statusit të magjistratit Besnik Cengu në datën 14.2.2023.* 3. *Njoftimin e tij dhe institucioneve përkatëse me këtë vendim*”.

18. Subjekti ka konfirmuar se me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë i ka përcjellë subjektit dhe Komisionit vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, për “Miratimin e pensionit të parakohshëm” dhe “Mbarimin e statusit të magjistratit”, me datë 14.2.2023.

19. Subjekti ka cituar dispozitat ligjore mbi të cilat është bazuar Këshilli i Lartë i Prokurorisë në vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, për “Miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit Besnik Cengu” dhe, më konkretisht, ka theksuar se arsyetimi i vendimit është bazuar në nenin 27, pikat 1, 1/2 dhe 3, nenin 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

20. Subjekti ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit se ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes së tij, duke theksuar se e vërteta është se ka kërkuar miratimin e pensionit të parakohshëm dhe *mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të miratimit të pensionit të parakohshëm të pleqërisë*, pra të daljes në pension të parakohshëm të pleqërisë dhe jo për shkak dorëheqjeje, sikurse ka cituar Komisioni në materialin e raportit të dërguar.

21. Subjekti ka kundërshtuar gjithashtu edhe konstatimin tjetër të Komisionit në materialin e raportit të dërguar, ku citohet se *deri në këto momente vërehet dhe konfirmohet vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi subjekti Besnik Cengu ka paraqitur dorëheqje para Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe pasi Këshilli ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit, subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi, i cili duhet të këtë marrë*

<sup>3</sup>Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>4</sup>Depozituar në seancën dëgjimore, datë 2.3.2023.

*formë të prerë*, duke theksuar se edhe ky pretendim nuk është i vërtetë dhe nuk konfirmon vullnetin e tij se ka paraqitur dorëheqje para Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**22.** Subjekti ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit se mosparaqitja e ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë konfirmon vullnetin e tij për dorëheqje.

**23.** Në vijim, subjekti ka parashtruar se vetë ai ka njoftuar Komisionin se nuk do të ushtronte ankim ndaj vendimit të KLP-së, pasi ka qenë dakord me këtë vendim, e cila ka pranuar kërkesën e tij për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit, ashtu siç e ka kërkuar, por jo mbarimin e statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje siç referohet nga Komisioni.

**24.** Subjekti është shprehur se fakti që nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit nuk do të thotë se ka paraqitur dorëheqje, por konfirmon se vendimi i Këshillit është i drejtë dhe nuk bën fjalë në asnjë pikë të tij dhe në asnjë dispozitë, qoftë në pjesën arsyetuese, në bazën ligjore ku ai është mbështetur dhe në pjesën urdhëruese (dispozitiv) nuk përmendet dorëheqje, pasi kjo nuk ka ndodhur.

**25.** Subjekti ka rikonfirmuar se nuk ka asnjë fakt ku të evidentohet që ai ka dhënë dorëheqje nga detyra dhe, në këto kushte, ka sqaruar se përfundimi që ka arritur Komisioni në raportin e dërguar se ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh ligji, Kushtetuta për dorëheqje është tërësisht i pabazuar në prova dhe në ligj.

**26.** Ai ka theksuar se ka shfrytëzuar të drejtën që i jep ligji për pensionin e parakohshëm, neni 27, pikat 1, 1/2 dhe neni 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili nuk bën fjalë kurrsesi për dorëheqje por për të drejtën e pensionit të parakohshëm që gëzon magjistrati, si dhe rastin kur mbaron statusi i magjistratit, që në rastin konkret ka plotësuar kriteret ligjore për pensionin e parakohshëm dhe, për këtë shkak, ka mbaruar statusi i magjistratit Besnik Cengu dhe jo për shkak të dorëheqjes, siç pretendohet nga ana e Komisionit, pasi dorëheqja parashikohet në nenin 64, pika 1, germa “a”, nenin 65 dhe në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.

**27.** Subjekti ka konfirmuar se në asnjë nga këto nene nuk është përmendur apo citohet qoftë në kërkesën e tij, ashtu edhe në vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për “Miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit Besnik Cengu”.

**28.** Subjekti në parashtrimet e tij insiston se në asnjë rast nuk ka dhënë dorëheqje para Këshillit të Lartë të Prokurorisë, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, as sipas nenit 64, germa “a” dhe as sipas nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por ka kërkuar miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit, bazuar në nenin 27, pikat 1 dhe 1/2, nenin 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, dhe mbi bazën e kësaj kërkesë Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, ka vendosur “Miratimin e pensionit të parakohshëm për z. Besnik Cengu dhe mbarimin e statusit të magjistratit Besnik Cengu në datën 14.2.2023”.

**29.** Subjekti ka deklaruar se në këto kushte, *de facto* dhe *de jure*, rezulton se Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar kërkesën e tij për pension të parakohshëm dhe jo kërkesën për

dorëheqje, sikurse i kërkohet të konfirmojë me *email*-in e dërguar në adresën e tij zyrtare, në datën 9.2.2023, si dhe në rezultatet e dërguara me *email*-in e datës 28.2.2023 dhe, për këtë arsye, kërkon që nga ana e Komisionit të merret parasysh kërkesa për mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të miratimit të pensionit të parakohshëm dhe jo të dorëheqjes.

**30.** Subjekti ka kërkuar që përmbajtja e vendimit të Komisionit në pjesën përshkruese - arsyetuese dhe pjesën urdhëruese të pasqyrojë saktë bazën ligjore dhe dispozitivin e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Subjekti ka sjellë në vëmendje edhe vendimin nr. OO-2022-2373, vendimi (362), datë 25.10.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ku është arsyetuar sa i përket mbarimit të statusit të magjistratit, neni 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohen në mënyrë shteruese rastet e mbarimit të statusit të magjistratit.

**31.** Subjekti ka shtuar se as ai nuk ka dhënë dorëheqje nga detyra dhe as Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka arsyetuar dhe nuk ka vendosur bazuar në këtë dispozitë, por në nenin 64, pika 1, germa “c” dhe jo germa “a” e ligjit, qoftë në pjesën arsyetuese ku ka cituar bazën ligjore ku është mbështetur, ashtu edhe në pjesën urdhëruese (dispozitiv) ku ka vendosur miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit Besnik Cengu, në datën 14.2.2023 (shihni vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë). Ai thekson se nuk ka dhënë dorëheqje as bazuar në nenin 64, pika 1, germa “a”, as sipas nenit 65, pikat 1 dhe 2 dhe as sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

**32.** Në të tilla rrethana, subjekti ka deklaruar se objekti për të cilin ka nisur procedura e rivlerësimit apo qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur, referuar nenit 95 “Pamundësia në objekt apo qëllim” të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i cili specifikon se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.

**33.** Subjekti referon edhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative për rastet kur institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Po ashtu, subjekti në qëndrimin e tij ka parashtruar se aktualisht është pensionist dhe jo magjistrat dhe, për rrjedhojë, edhe çështja që po shqyrtohet nga trupi gjykues i Komisionit nuk ka objekt rivlerësimi kalimtar.

**34.** Në përfundim, subjekti ka kërkuar të deklarohej i përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet e konstatuara dhe ligjin e zbatueshëm**

**35.** Trupi gjykues, duke analizuar shpjegimet dhe kërkimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, vendimin e KLP-së për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, dokumentacionin në tërësi të administruar në dosjen objekt të këtij procesi administrativ në raport me ligjin e zbatueshëm për raste të kësaj natyre, arsyeton si vijon:

**36.** Nga dokumentacioni i administruar u provua se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prej vitit 1985.

**37.** Rezulton se subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e tij nr. \*\*\*, datë 12.12.2022, drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ka kërkuar daljen në pension të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit prokuror.

**38.** Kërkesa e subjektit të rivlerësimit bazohet në nenin 27, pikat 1 dhe 1/2 dhe nenin 64, pika 1, germa “c” e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**39.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, bazuar në nenin 27, pikat 1, 1/2 dhe 3, nenin 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2022, të paraqitur prej tij, me propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, ka vendosur: “1. Miratimin e pensionit të parakohshëm për z. Besnik Cengu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. 2. Mbarimin e statusit të magjistratit Besnik Cengu në datën 14.2.2023. 3. Bërjen e njoftimeve përkatëse”.

**40.** Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, mori në shqyrtim shkaqet e paraqitura nga subjekti në kërkesën e tij, ku nga verifikimi i përmbajtjes së saj rezultoi se subjekti kishte paraqitur si shkak për daljen në pension të parakohshëm përmbushjen e kriterëve ligjore, duke bërë me dije se ka mbi 10 vjet që trajtohet nga kardiologu për diagnozat e sëmundjes infarkt miokardi, hipertension arterial, fibrilacion arterial dhe insuficiencë kardiake.

**41.** Nga leximi literal i përmbajtjes së kërkesës, trupi gjykues konstaton se nuk pasqyrohet në asnjë paragraf si shkak “dorëheqja”. Për pasojë, edhe vendimi nr. \*\*\*, datë 30.1.2023, i KLP-së, për “Miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit prokuror Besnik Cengu”, nuk ka përcaktuar si shkak të marrjes, “dorëheqjen”. Ky fakt në vlerësim të trupit gjykues mbetet i pakontestueshëm.

**42.** Në këto rrethana rezulton se vendimi i KLP-së është rezultat i kërkimit të subjektit të rivlerësimit bazuar në legjislacionin e aplikueshëm dhe, për pasojë, ka përmbushur pritshmëritë e kërkuesit sipas kërkimit të tij, duke u bërë kështu i paankimueshëm.

**43.** Trupi gjykues, nga analizimi i të dhënave të administruara për të vlerësuar nëse subjekti përmbushte kriteret e përcaktuara në nenin 27<sup>5</sup>, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016, për të përfituar daljen e tij në pension të parakohshëm, konstatoi se subjekti ka mbushur moshën 60 vjeç dhe ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, sikurse kërkon ky parashikim ligjor.

**44.** Në të tilla kushte, subjekti i rivlerësimit ka qenë plotësisht i legjitimuar në kërkimin e tij, të cilin e ka bazuar në nenin 64, germa “c”<sup>6</sup> e po këtij ligji, nenin 52<sup>7</sup> të Kushtetutës, ka respektuar të drejtën e pakufizuar të njohur nga ligji për të dalë në pension të parakohshëm dhe, për rrjedhojë, vlerësohet se vendimmarrja e trupit gjykues bazohet në parimin e ligjshmërisë së

---

<sup>5</sup>Pensioni i parakohshëm: “1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse: a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç; b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit”.

<sup>6</sup>Neni 64, pika 1, germa “c” dhe pika 5, i ndryshuar, citohet: “i. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji. 5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç...”.

<sup>7</sup>Neni 52/1: “Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paafte për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj. 2. Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj”.



parashikuar në nenin 4<sup>8</sup> të Kodit të Procedurës Administrative, pavarësisht arsyeve të gjendjes së tij shëndetësore<sup>9</sup>, që e kanë vënë në lëvizje për të kërkuar daljen në pension të parakohshëm.

**45.** Megjithatë, në këtë drejtim, trupi gjykues vëren se ligjvënësi ka parashikuar të drejtën e ushtrimit të kërimit për dalje në pension të parakohshëm<sup>10</sup> pa parashikuar kushte e pasoja, duke rregulluar këtë moment, krahas së drejtës për të kërkuar pensionin e pleqërisë.

**46.** Trupi gjykues vlerëson se paraqitja e kërkesës për miratimin e pensionit të parakohshëm pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk mund të konsiderohet si shprehje e vullnetit për të ndërprerë marrëdhëniet e punës ose për të lënë detyrën përpara kohe përkundrejt mundësisë ligjore për të vazhduar funksionin, por si një e drejtë ligjore për të dalë në pension të parakohshëm e parashikuar shprehimisht në ligj, qoftë për pensionin e parakohshëm, ashtu edhe për pensionin e plotë kur mbush moshën 67 vjeç dhe kërkesa për miratimin e pensionit të parakohshëm nuk mund të barazohet apo të kualifikohet si dorëheqje nga detyra.

**47.** Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se pasoja e ardhur pas miratimit të pensionit të parakohshëm, i cili i paraprin pensionit të pleqërisë dhe njëkohësisht është i parashikuar ekzaktësisht si institut më vete në ligj, është e barasvlefshme me pasojën që vjen nga dalja në pension pleqërie. Në të tilla kushte, ashtu sikurse dalja në pension pleqërie nuk bashkëshoqërohet me ndalimin e parashikuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, edhe miratimi i kërkesës për dalje në pension të parakohshëm nuk mund të bashkëshoqërohet me këtë ndalesë.

**48.** Në lidhje me pasojën e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit dhe moszbatimin e ndalimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës në çështjen objekt vlerësimi, trupi gjykues arsyeton si vijon:

**49.** Instituti i daljes në pension është i ndryshëm nga ai i dorëheqjes dhe, për pasojë, këto dy institute nuk mund të ndërlidhen dhe as të zëvendësojnë njëri-tjetrin. Në vlerësim të trupit gjykues këto dy institute nuk duhen konfliktuar me njëri-tjetrin në dëm të pozitës së subjektit të rivlerësimit.

**50.** Kërkimi i subjektit për daljen e tij në pension të parakohshëm nuk ka ardhur nga rrethana apo arsye që vareshin prej tij, arsye të cilat në rast se në një të ardhme hipotetike do të mungonin, atëherë padyshim do t'i mundësonin subjektit ushtrimin e të drejtës për të kërkuar vijimin e marrëdhënieve të punës në kuadër të zotërimit të sigurisë juridike që ai vazhdon ta gëzojë, porse do të përballlej me zbatimin e legjislacionit në fuqi në kohën e kërimit.

**51.** Më konkretisht, ligjvënësi në ligjin nr. 96/2016 ka parashikuar në nenin 64<sup>11</sup>, gerrat “a” dhe “c”, rastet e mbarimit të statusit të magjistratit. Parashikimi në gerrën “a” referon rastin e

---

<sup>8</sup>Neni 4, “Parimi i ligjshmërisë”, citohet: “1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveçse kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”.

<sup>9</sup>Depozituar raport mjekësor edhe pranë Komisionit.

<sup>10</sup>Neni 27 i ndryshuar me ligjin nr. 50/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/2 me këtë përmbajtje: “1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfutimit deri në plotësimin e kushteve për përfutimin e pensionit të plotë të pleqërisë”.

<sup>11</sup>Referuar nenit 64 të ligjit nr. 96/2016.

mbarimit të statusit *kur magjistrati jep dorëheqjen*, ndërsa parashikimi në germën “c” referon rastin e mbarimit të statusit *kur magjistrati mbush moshën e pensionit*.

**52.** Në vijim, ligjvënësi ka parashikuar se në rastin e dhënies së dorëheqjes magjistratit nuk i kërkohet të motivojë kërkesën, ndërsa në rastin e mbushjes së moshës së pensionit kërkesa përfshin përmbushjen e kriterëve ligjore, sikurse ka ndodhur, si dhe natyrshëm motivin e saj.

**53.** Në logjikë të thjeshtë, dhënia e dorëheqjes si një alternativë pa argument për të lënë funksionin, jo vetëm që nuk njih moshë apo vjetërsi në ushtrimin e funksionit, sikurse kërkon domosdoshmërisht kërkimi i daljes në pension të parakohshëm, por për shkak të objektit dhe qëllimit të ligjit nr. 84/2016 duket si një mjet për t’iu shmangur procesit të rivlerësimit dhe, për pasojë, me të drejtë ligjvënësi ka parashikuar në mënyrë eksplicite që mbarimi i statusit të magjistratit për këtë shkak shoqërohet edhe me penalizimin e parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, që subjekti i rivlerësimit të mos ushtrojë funksione si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

**54.** Aplikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës nuk është parashikuar për rastet e vendimmarrjes mbi kërkesën për dalje në pension të parakohshëm, ndërsa, në mënyrë eksplicite dhe pa asnjë ekuivok, mbarimi i statusit të magjistratit, bazuar në pikën 1, germa “a” e nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 sjell si pasojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e ndalimit të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.

**55.** Në këto kushte, një aplikim apriori i kësaj dispozite në çështjen objekt shqyrtimi, në ndryshim nga subjekti, i cili ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit sipas nenit 64/1/c të ligjit nr. 96/2016, do të shkelte parimin e sigurisë juridike<sup>12</sup> të palës/subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, do t’i vishej atij me pa të drejtë. Gjithashtu, një vlerësim apriori do të cenonte parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 4 i ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.

**56.** Trupi gjykues çmon se çdo vendimmarrje në ndryshim të këtij arsytimi ligjor do të bënte që subjekti i rivlerësimit të penalizohej pa ligj, veprim që do të binte ndesh me Kushtetutën, ligjet në fuqi që janë referuar në këtë arsytim, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

---

<sup>12</sup>“Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (shihni vendimet nr. 9, datë 26.2.2007 dhe nr. 40, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (vendimet nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 40, datë 7.7.2014; dhe nr. 10, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e individit dhe shoqërisë të shteti e ligji, madje edhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishe, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë edhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e së drejtës dhe garancisë (vendimet nr. 40, datë 7.7.2014; nr. 11, datë 6.3.2014; nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 11, datë 4.4.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 2.11.2005; dhe nr. 34, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese)”.

**57.** Në çmuarjen e trupit gjykues, parashikimi i pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës është i lidhur me vullnetin dhe qëndrimin subjektiv të magjistratit për t'u larguar nga detyra dhe jo me shkaqe objektive, sikurse është rasti i subjektivit të rivlerësimit.

**58.** Trupi gjykues vlerëson se në këtë rast nuk ndërlidhet shkaku objektiv i largimit nga detyra, i parashtruar nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 96/2016, me shkakun subjektiv, sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, pasi në ndryshim nga parashikimi i bërë në nenin 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundësi të vazhdojë të ushtrojë detyrën deri në moshën e parashikuar nga ligji për të dalë në pension të plotë pleqërie.

**59.** Në analizë të legjislacionit të aplikueshëm vërehet se në të dy institutet paraprakisht funksionon dhe mbetet i pandryshuar *miratimi i mbarimit të statusit të magjistratit*, i cili jo domosdoshmërisht sjell të njëjtën pasojë.

**60.** Zbatimi i të drejtës për të dalë në pension të parakohshëm është një e drejtë e garantuar nga ligji i posaçëm, i cili përcakton edhe se pensioni i parakohshëm nuk është gjë tjetër veçse një pension pleqërie që objektivisht sjell pengesë ligjore për të ushtruar detyrën e prokurorit/magjistratit, sikurse është konstatuar edhe me vendimin e KLP-së, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

**61.** Miratimi i kërkesës për pension të parakohshëm, sipas nenit 27 të ligjit nr. 96/2016, ndryshuar me ligjin nr. 50/2021, kërkon plotësimin e disa kushteve, përmbushja e të cilave ka çuar në pranimin e kërkesës nga KLP-ja, duke mundësuar në këtë mënyrë që magjistrati të gëzojë të drejtën e pensionit të parakohshëm, sipas këtij neni dhe mbarimit të statusit të magjistratit sipas nenit 64, pika 1, germa “c” e po këtij ligji, i ndryshuar.

**62.** Trupi gjykues vlerëson se për sa kohë dy institutet janë të ndara dhe të parashikuara në baza ligjore të ndryshme, me pasoja financiare gjithashtu të ndryshme, nuk mund të ndërlidhen dhe aplikohen në funksion të vijimit apo ndërprerjes së procesit të rivlerësimit.

**63.** Subjekti ka shfaqur vullnetin dhe ka dalë në pension sipas Kushtetutës për shkaqe objektive dhe ligjore të parashikuara shprehimisht nga neni 6, pikat 2 dhe 1/2, si dhe neni 27, pika 1, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016.

**64.** Trupi gjykues mban në konsideratë faktin që këto dy institute përjashtojnë njëra-tjetrën, duke sjellë në të vërtetë në të dyja rastet ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, por ndryshojnë me njëri-tjetrin, pasi dalja në pension është e lidhur domosdoshmërisht me moshën, ku magjistrati duhet të ketë mbushur moshën 60 vjeç, të ketë qenë në ushtrim të funksionit si magjistrat të paktën për 30 vjet, kushte të cilat u provuan nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa dorëheqja shpreh një vullnet subjektiv të pakushtëzuar të individit kur ende ekzistojnë marrëdhëniet e punës së magjistratit, e cila shoqërohet me pasojat ligjore të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

**65.** Trupi gjykues, në rastin objekt vlerësimi, i jep peshë në procesin e deklaramit të përfundimit të statusit të magjistratit identifikimit të saktë të shkakut të përfundimit të tij, pasi për secilin nga rastet e nenit 64, pika 1, ligji ka parashikuar pasoja dhe efektet juridike, të cilat prekin interesat e magjistratit.

**66.** Në përfundim, trupi gjykues konkludon se kërkesa e magjistratit për miratimin e pensionit të parakohshëm është një e drejtë ligjore sipas nenit 27, pikat 1 dhe 1/2 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe miratimi i kësaj kërkesë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nën këtë objekt, sipas nenit 64, pika 1, germa “c” e po këtij ligji, nuk mund të konsiderohet si refuzim i subjektit të rivlerësimit për të vijuar ushtrimin e detyrës së magjistratit deri në moshën 67 vjeç dhe nuk mund të referohet/barazohet si dorëheqje nga detyra e magjistratit, në kuptim të germës “a” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, që do të passillte ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e ndalimit të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.

**67.** Rrethanat e mësipërme të gërshetuara edhe me faktin se aktualisht subjekti ka statusin e pensionistit dhe jo të magjistratit, çmohen nga trupi gjykues se objekti për të cilin ka nisur procedura e rivlerësimit për këtë subjekt është bërë i pamundur.

**68.** Në konkluzionin përfundimtar, trupi gjykues, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 6 të nenit 4, ku parashikohet se, kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji, si dhe në nenin 90, pika 3 e këtij Kodi, ku parashikohet se *proceduara administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi*, çmon të aplikojë nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, nën titullin “Pamundësia në objekt apo qëllim”, ku thuhet shprehimisht se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, germa “c” e pikës 1 e nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Besnik Cengu, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 3.3.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**

**Kryesuese**

**Roland ILIA**

**Relator**

**(kundër)**

**Brunilda BEKTESHI**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Amela Idrizi*